



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:249109

Datë: 27.05.2024

Numri i dokumentit: 05737062

CAP.nr.1044/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtaren Halide Reka, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit R... B... (R...) me seli në Prishtinë, kundër debitorëve Kompania "P... C..." sh.p.k me seli në Prizren, e përfaqësuar nga pronarja F... K... nga fshati B..., Komuna e Prizrenit dhe F... K... nga P..., me bazë juridike përmbartimore për pagesën e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren , CP.nr.273/2014 të datës 02.06.2023, jashtë seance me datë 27.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Divizioni Civil, shpallet jo kompetent në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike përmbartimore.

II. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi lënda t'i dërgohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë – Dhomës së Shkallës së Dytë – Departamentit për Çështje Ekonomike, si gjykatë kompetente në pikëpamje lëndore.

Arsyetim

Gjykata Themelore në Prizren, me aktvendimin e atakuar CP.nr.273/2014 të datës 02.06.2023, në pikën I të dispozitivit e ka përfunduar procedurën përmbartimore, në këtë çështjen juridike të përmbartimit CP.nr.273/14, për përmbartimin e dokumentit të përmbartimit – Marrëveshjes së pengut të dt. 04.12.2009, për shkak të detyrimit në të holla në emër të kredisë në shumën prej 949.150.42 eurove, dhe atë për shkak të pa mundësisë së përmbartimit. Në pikën II të dispozitivit është vendosur që shpenzimet e procedurës së përmbartimit, bien në ngarkim të kreditores së përmbartimit.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori R... B... (R...) me seli në Prishtinë, duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta aprovoj ankesën e kreditorit, ta prishë aktvendimin e ankimuar dhe lënda ti kthehet gjykatës së njëjtë në procedim të serishëm dhe të mbetet në fuqi Aktvendimi i kësaj gjykate Cp.nr.273/14 të datës 19.02.2014 përmes të cilit është lejuar propozimi për përmbarrim.

Gjykata e Apelit e Kosovës, si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të tjera të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 29, 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), ka gjetur se: bazuar në nenin 13 par.1 pika 1.1 të Ligjit për Gjykatën Komerciale të Kosovës, parashihet se: *1.Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.1. kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre; dhe sipas nenit 13 par.6 pika 6.1 të Ligjit për Gjykatën Komerciale të Kosovës parashihet se: 6.Dhomat e shkallës së dytë janë kompetente për të trajtuar: 6.1. të gjitha ankesat ndaj vendimeve të dhomave të shkallës së parë brenda kompetencave të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, andaj referuar këtyre dispozitave ligjore dhe duke qenë së palët ndërgjyqëse në këtë procedurë janë shoqëri tregtare, për vendosje në këtë çështje juridike përmbarrimore, kompetente në pikëpamje lëndore është Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhomat e Shkallës së Dytë.*

Nga të cekurat, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në bazë të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 29 dhe 208 të LPK-së, e lidhur me nenin 13 par.1 pika 1.1 dhe par.6 pika 6.1 të Ligjit për Gjykatën Komerciale nr.08/L-015.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CAP.nr.1044/2023, me datë 27.05.2024

Gjyqtarja
Halide Reka, d.v.